



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Korrik - Shtator 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, për periudhën kohore Korrik - Shtator 2024.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Korrik - Shtator 2024

Aktakuzë për keqpërdorim të pozitës zyrtare

Prizren, 26 Korrik 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve D.H., dhe I.I., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, nga data 04.04.2022 e deri me datë 26.01.2024 në zyrën për ekzekutimin e sanksioneve penale pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në cilësinë e personave zyrtar - duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, D.H., në pozitën e bashkëpunëtorit profesional në zyrën e ekzekutimit të sanksioneve penale si dhe I.I., në pozitën e referentit në zyrën e ekzekutimeve të sanksioneve, në bashkëkryerje nuk i përmbushin detyrat zyrtare, me qëllim të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, në atë mënyrë që me dashje nuk i kanë dorzuar, duke i fshehur Urdhëresat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe atë nëntë (9) lëndë, të cilat kanë qenë dashur të dërgohen për ekzekutim duke i mundësuar të dënuarve, t'i shmangen mbajtjes së dënimit me burg, apo kryerjes së pagesave në emër të dënimit të shqiptuar në të holla, duke i shkaktuar dëm Sistemit Gjyqësor.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Korrik - Shtator 2024


Prokuroria Themelore në Prizren e hapur për takime me qytetarë

Prizren, 17 Korrik 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, vazhdon të mbajë takimet e hapura me qytetarë, të cilët shprehin interes që të takohen me Kryeprokurorin e kësaj prokurorie, Admir Shala.



Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, në vazhden e takimeve të ndryshme javore, **ditën e mërkurë, nga ora 13:00 - 15:00**, e ka të caktuar për takime me qytetarë në zyrën e tij, për të gjitha palët e interesuara.

Në takimet me qytetarë, Kryeprokurori Shala, ka biseduar për çështje dhe kërkesa të ndryshme, duke u nisur nga kërkesat dhe interesimet për lëndë individuale, e deri tek



rastet kur qytetarët shprehin bashkëpunimin për të informuar Kryeprokurorin për kryes dhe vepra të mundshme penale.

Të gjithë të interesuarit drejtpërdrejt nga Kryeprokurori Shala, janë njoftuar me çështjet për të cilat kanë shprehur interesim, duke u dhënë sqarimet e duhura.

Po ashtu, Kryeprokurori i siguroi qytetarët dhe shprehi gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë për zgjidhjen e çështjeve të parashtruara, duke u ofruar mbështetjen e Prokurorisë që ai e udhëheq.

Prokuroria Themelore e Prizrenit, si institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi ligjore dhe Kushtetuese mbetet e përkushtuar për të jetësuar praktikën e mira që mundësojnë efikasitet, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj, me qëllimin e vetëm për luftimin e çfarëdo lloji natyre të kriminalitetit që bie mbi kompetencën dhe përgjegjësinë e kësaj prokurorie.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024

Aktakuzat e ngritura gjatë muajit Korrik 2024



Departamenti i Krimeve të Rënda
Nëntë (9) aktakuza kundër dhjetë (10) personave.



Departamenti i Përgjithshëm
Njëqind e tridhjetë (130) aktakuza kundër njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë (169) personave.



Departamenti për të Mitur
Njëzet e shtatë (27) propozime kundër tridhjet e tre (33) personave (të mitur).

Prokuroria e Prizrenit për një muaj ka ngritur njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë aktakuza

Prizren, 07 Gusht 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, gjatë muajit korrik 2024, ka ngritur gjithsej njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (166) aktakuza kundër dyqind e dymbëdhjetë (212) personave, për raste të ndryshme penale.

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, janë ngritur nëntë (9) aktakuza kundër dhjetë (10) personave.

Departamenti i Përgjithshëm, i kësaj prokurorie gjatë muajit korrik, ka ngritur njëqind e tridhjetë (130) aktakuza kundër njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë (169) personave, për vepra të ndryshme penale.

Ndërsa, nga Departamenti për të Mitur, janë ngritur njëzet e shtatë (27) propozime për shqiptim të masës edukative ose dënimit, kundër tridhjet e tre (3) të miturve.

Prokuroria Themelore në Prizren, mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024

Prokuroria e Prizrenit gjatë muajit korrik ka ngritur 25 aktakuza për Dhunë në Familje

Prizren, 08 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, gjatë muajit Korrik 2024, ka pranuar dyzet e një (41) kallëzime penale kundër dyzet e nëntë (49) personave, lidhur me veprat penale që lidhen me dhunë në familje.



Gjatë muajit korrik, nga kjo prokurori janë ngritur njëzet e pesë (25) aktakuza kundër tridhjetë (30) personave, për veprat penale që lidhen me dhunë në familje.

Prej këtyre rasteve, shtatëmbëdhjetë (17) aktakuza më njëzet (20) persona, janë aktakzua ku të dëmtuara janë gratë.


Prokuroria Themelore në Prizren, do të vazhdojë t'i trajtoj me seriozitet të theksuar të gjitha rastet e dhunës në familje, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar dhe luftuar veprat penale të kësaj natyre.

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve

Prizren, 12 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit K.O., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Sipas aktakuzës, i pandehuri K.O., me datë 22.05.2024 rreth orës 20:35, në vendkalimin kufitar të pikës kufitare në Vërmicë, duke hyrë në Kosovë nga Republika e Shqipërisë, pa autorizim ka poseduar narkotikë të llojit “marihuanë” me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të tij nga ana e policisë, në veturën “Honda Jazz”, të cilën veturë ishte duke e vozitur i pandehuri, e pikërisht në brendësi të motorit të veturës, policia ka gjetur dhe sekuestruar një (1) qese najloni të tejdukshme me substancë narkotike të llojit



“marihuanë” në peshë 86.89 gram, ndërsa në trup të tij, i është gjetur një qese najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit “marihuanë” në peshë 0.90 gram, e për transportin e se cilës substancë narkotike nuk ka pasur autorizim përkatës.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohen të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024

Prokuroria Themelore në Prizren brenda javës ka ngritur 35 aktakuza kundër 40 personave

Prizren, 19 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren brenda javës, përkatësisht për pesë ditë pune, nga data 12 – 16 gusht 2024, ka ngritur tridhjet e pesë (35) aktakuza kundër dyzet (40) personave, për vepra të ndryshme penale.



Këto aktakuza janë ngritur nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.


Nga numri total i këtyre aktakuzave, katërbëdhjetë (14) aktakuza kundër katërbëdhjetë (14) personave, janë aktakuza për dhunë në familje.

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve

Prizren, 20 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit Sh.G., i cili gjendet në paraburgim, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Sipas aktakuzës, i pandehuri Sh.G., me datë 02.07.2024, në ora 17:35 në Pikën e kalimit kufitar të Vërmicës, pa autorizim transporton substanca apo preparate, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pasi policia kufitare kishte ndaluar automjetin e markës “AUDI A8”, të cilin ishte duke e drejtuar vëllai i të pandehurit, A.G., gjatë kontrollit të automjetit, saktësisht në ulësen e pasme të tij, policia ka gjetur një qese plastike me ngjyrë të verdhë me substancë narkotike të llojit “marihunë”, në peshë të përgjithshme prej 300 gram (treqind gram), të cilën substancë e kishte blerë i



pandehuri në Shëngjin të Republikës së Shqipërisë në shumën prej 500 € (pesëqind euro), me qëllim që të njejtën ta vë në qarkullim për shitje brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Aktakuzë për grabitje

Prizren, 22 Gusht 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit E.B., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale “Grabitja” nga neni 317, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Sipas aktakuzës, me datë 10.06.2024, në orën 23:24 në Rr. “Zara” në Prizren, me përdorim të forcës, sulmon jetën apo trupin e personit tjetër duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që vetes t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që derisa viktima F.K., ishte duke ecur përgjatë rrugës në fjalë, i njëjti në mënyrë dinake i vihet nga pas dhe në mënyrë jashtëzakonisht të dhunshme e godet viktimën me grusht në anën e djathtë të kokës – fytyrës së saj, e cila menjëherë mbetet pa ndjenja - e alivanosur në tokë, me ç’rast i njëjti shfrytëzon momentin e volitshëm ashtu që përvetëson telefonin dhe

çantën e saj dhe largohet në shpejtësi nga vendi i ngjarjes, duke i shkaktuar viktimës F.K., dëm pasuror dhe lëndime të lehta trupore - të konstatuara sipas akt-ekspertimit mjeko-ligjor.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024


Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Prizren

Prizren, 26 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren brenda javës, nga data 19 – 25 gusht 2024, ka regjistruar gjithsej nëntëdhjetë e shtatë (97) lëndë me njëqind e tridhjetë e një (131) persona.

PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN

PËRMBLEDHJE E PUNËS JAVORE
19-25 GUSHT 2024

- ◆ 97 lëndë të pranuar me 131 persona
- ◆ 11 lëndë me 11 persona për dhunë në familje
- ◆ 55 aktakuza kundër 77 personave
- ◆ 10 persona të ndaluar
- ◆ 10 kërkesa për paraburgim



Në mesin e lëndëve të pranuara, njëmbëdhjetë (11) lëndë me njëmbëdhjetë (11) persona kanë qenë për dhunë në familje.

Po ashtu, gjatë kësaj jave janë ngritur pesëdhjetë e pesë (55) aktakuza kundër shtatëdhjetë e shtatë (77) personave, për vepra të ndryshme penale.

Këto aktakuza janë ngritur nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Përgjithshëm.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave me urdhër të prokurorëve kujdestar, janë ndaluar dhjetë (10) persona, në dhjetë raste të ndara, për të cilët është bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Korrik - Shtator 2024

Prokuroria e Prizrenit Organizoi Takim Përshëndetës për Kryeprokurorin Admir Shala

Prizren, 30 Gusht 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, ka organizuar takim përshëndetës për Kryeprokurorin Admir Shala, pasi që i njëjti ka përfunduar mandatin, pas miratimit të dorëheqjes së tij nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Në këtë ceremoni, U.D. Kryeprokurori Petrit Kryeziu dhe anëtarja e KPK-së Arijana Shajkovci si dhe prokurorët dhe stafi i Prokurorisë Themelore në Prizren, falenderuan Kryeprokurorin Admir Shala për punën dhe kontributin e dhënë në sistemin prokurorial, duke çmuar lartë përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar përgjatë këtyre viteve.





Nga ana tjetër Kryeprokurori Shala, ka falenderuar të gjithë punonjësit e Prokurorisë Themelore në Prizren për respektin, mbështjetjen dhe bashkëpunimin që ka pasur me të gjithë, gjatë periudhës së punës në këtë prokurori.

Kryeprokurori Admir Shala, do të vazhdoj punën si Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Speciale.

Më herët, Kryeprokurori Shala, nga muaji tetor i vitit 2010 deri në nëntor të vitit 2013 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë Themelore në Prizren. Ndërsa, nga nëntori i vitit 2013 deri në dhjetor 2016 ka punuar si prokuror në Prokurorinë Speciale. Nga data 01 janar 2017, për dy mandate ka ushtruar funksionin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Korrik - Shtator 2024

Prokuroria e Prizrenit kërkon Paraburgim për Katër Persona për Lëndim të lehtë trupor dhe Kanosje

Prizren, 01 Shtator 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren, caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurve Ç.S., D.S., F.B., për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor" nga neni 185, si dhe kundër të dyshuarit - zyrtarit policor I.S., për shkak të veprës penale "Kanosja" nga neni 181 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)



Të pandehurit Ç.S., D.S. dhe F.B., më datë 31.08.2024 rreth orës 15:50^{min}, në Prizren, në rrugën "Wiliam Wolker", pikërisht në parkingun e një Qendre Tregtare, në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmtojnë shëndetin të dëmtuarit S.B., në atë mënyrë që në momentin kur i dëmtuari ishte nisur për tek automjeti të cilin e kishte parkuar në oborrin e qendrës tregtare, është ndalur i pandehuri Ç.S., ku fillimisht kishte filluar konflikti verbal në mes tyre, pastaj Ç.S., e godet me kokë dhe aty ndërhyjnë edhe të pandehurit D.S., dhe F.B., të cilët me grushta e godasin në pjesë të ndryshme të trupit, me çka të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime

trupore, të përshkruara si në raportin mjekësor të lëshuar nga Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren.

Me këto veprime të njëjtin, në bashkëkryerje ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor" nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të pandehurit Ç. S. dhe D. S., pasi i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit, ku ndërhyjnë zyrtarët policorë për ta ndalur sulmin, në prani të zyrtarëve policorë, e kanosin të dëmtuarin me fjalët "s'ka me të nxan nata, kemi me të vra", me ç' rast tek i njëjti kanë shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetën e tij.

Me këto veprime në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale "kanosje" nga neni 181 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu, nga Departamenti i Përgjithshëm, është parashtruar kërkesë për caktim të paraburgimit edhe ndaj të pandehurit I.S.,- zyrtar policor, pasi që ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti më datë 31.08.2024 rreth orës 17:30^{min}, paraqitet në stacion policor për t'u interesuar për djemtë e tij të cilët ishin të përfshirë në rrahje, i njëjti në prezencë të hetuesit - zyrtarit policor V.M., e kanos të dëmtuarin S.B., me fjalë se do ta privojë nga jeta. Me këto veprime për të njëjtin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprën penale "Kanosja" nga neni 181 par.2 të KPRK- së.

Prokuroria Themelore në Prizren, mbetet e përkushtuar në trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve para ligjit, luftën ndaj kriminalitetit, forcimin e sundimin të ligjit dhe vënien para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin.

**Aktakuzë për Falsifikim të Dokumentit Zyrtar dhe Hyrje të Paautorizuar
Kompjuterike**

Prizren, 09 Shtator 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit M.Ş., turk - shtetas i Republikës së Kosovës, i cili gjendet në paraburgim nga data 05.03.2024, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në vazhdimësi ka kryer veprat penale "*Falsifikimi i dokumentit zyrtar*" nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe "*Hyrja e paautorizuar kompjuterike*" nga neni 277/D par.2 të Ligjit NR. 08/L -188 për Plotësimin dhe Ndryshimin e KPRK-së, lidhur me nenin 77 të KPRK- së.



Sipas aktakuzës, nga data 20.01.2021 në vazhdimësi deri më datë 05.01.2024, i pandehuri M.Ş., - në cilësinë e zyrtarit të gjendjes civile në Komunën e Mamushës, me dashje i tejkalon dhe keqpërdor autorizimet e tij ligjore, i njëjti nxjerr dokumente zyrtare të falsifikuara dhe ndërhyjnë në regjistrin zyrtar duke shënuar të dhëna të

rreme dhe me nënshkrimin e tij dhe me vulën zyrtare vërteton dokumentet zyrtare dhe regjistrin me përmbajtje të rreme, në atë mënyrë që i pandehuri fillimisht i regjistron në sistemin e gjendjes civile duke u lëshuar ekstrakte të lindjes dhe ua mundëson fitimin e shtetësisë 124 (njëqind e njëzet e katër) personave, të cilët i regjistron në sistemin e gjendjes civile për fitim të shtetësisë në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me Ligjin për Shtetësinë e Kosovës, dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës. Me këto veprime në vazhdimësi kryen veprën penale *“Falsifikimi i dokumentit zyrtar”*.

Po ashtu, në datat e lartëcekura, i pandehuri M.Ş., pa autorizim dhe me qëllim që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme dobi pasurore për vete dhe për personat tjerë, si dhe me qëllim që t’i shkaktoj dëm personit tjetër – Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC), hyn në sistemin kompjuterik të tjetrit – zyrtarit N.M., të cilit fillimisht arrin t’ia siguroj fjalëkalimin privat dhe më pas ia përdorë userin, nga ku regjistron të dhëna në sistemin e gjendjes civile dhe më pas në periudha të ndryshme kohore, i regjistron në sistem 113 (njëqind e trembëdhjetë) persona, të cilët pa qenë fare në librat amë të lindjes, dhe pa pasur fare dosje të verifikimeve, i regjistron në sistemin e gjendjes civile për fitim të shtetësisë dhe si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të pandehurit përmes hyrjes pa autorizim në sistemin kompjuterik të tjetrit, ua mundëson personave të lartcekur pajisjen me dokumente të Republikës së Kosovës. Me këto veprime në vazhdimësi ka kryer veprën penale *“Hyrja e paautorizuar kompjuterike”*.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Po ashtu prokurori, ka propozuar që përveç dënimit kryesor të pandehurit t’i shqiptohet edhe dënimi plotësues *Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, si dhe të bëhet anulimi i veprimeve juridike të kundërligjshme*, në drejtim të 124 (njëqind e njëzetë e katër) personave, të cilët janë regjistruar në mënyrë të kundërligjshme dhe të obligoj ARC-në që t’i shpallë të


pavlefshme dokumentet e tyre të nxjerra në emër të Republikës së Kosovës, duke përfshirë po pa u kufizuar në: certifikata, letërnjoftime dhe pasaporta.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024

U.D. Kryeprokurori i Prizrenit priti në takim Drejtorin e Policisë Rajonale të Prizrenit

Prizren, 18 Shtator 2024 – U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, ka pritur në takim pune Drejtorin e Policisë Rajonale të Prizrenit, Faton Alija, së bashku me komandantët e stacioneve policore për rajonin e Prizrenit, si dhe bashkëpunëtorët e tyre.





Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me ngritjen e bashkëpunimit në mes Prokurorisë Themelore në Prizren dhe Policisë, për problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

U.D. Kryeprokurori Kryeziu, kërkoi koordinim dhe ndërmarrje të veprimeve të përbashkëta sa i përket luftimit të kriminalitetit në përgjithësi, dhe në fokus të veçantë të jetë trajtimi i rasteve të dhunës në familje, korrupsionit, krimet kundër ambientit, fajdeja etj., me qëllim të parandalimit dhe ofrimit të sigurisë për qytetarët e vendit.

Drejtori Alija, gjatë këtij takimi njoftoi U.D. Kryeprokurorin Kryeziu, për situatën e sigurisë në rajonin e Prizrenit, dhe veprimet policore që po ndërmerren në vazhdimësi për të ofruar rend dhe siguri në këtë rajon.

Në fund të takimit, palët vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtejshëm.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Korrik - Shtator 2024

**Aktakuzë për Kontrabandim me Migrantë, Armëmbajtje pa Leje dhe
Shkaktim të Rrezikut të Përgjithshëm**

Prizren, 20 Shtator 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve S.G., A.H., H.A., O.A., M.H., A.B., dhe M.R., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale “Kontrabandimi me migrantë” nga neni 164, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, si dhe “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” nga neni 356, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).



Sipas aktakuzës, të pandehurit S.G., dhe A.H., nga fillimi i muajit mars të vitit 2023, e në vazhdim deri në ditën e arrestimit në bashkëkryerje me të pandehurit M.R., dhe A.B., (të arrestuar në Shqipëri) në baza ditore, organizojnë dhe

drejtojnë persona të tjerë, e pikërisht të pandehurit A.H., H.A., O.A., H.M., për kryerjen e veprës penale “Kontrabandimi me migrantë”, në atë mënyrë që të njëjtit i drejtojnë këta të pandehur dhe bëjnë organizimin e kontrabandimit të migrantëve sirian dhe migrantëve nga shtetet tjera arabe, duke i përcjellë të njëjtit rrugëve ilegale për t’i futur nga territori i Shqipërisë në territorin e Kosovës, dhe nga territori i Kosovës në territorin e Serbisë. Me këtë rast, për këtë periudhë kohore, për çdo ditë kontrabandojnë nga 10 deri 15 migrantë në ditë, e të cilët migrantë destinim të fundit i kishin shtetet e Bashkimit Evropian, ndërsa secili migrant për të kaluar nga territori i Shqipërisë deri në territorin e Serbisë, ka paguar nga 500 euro, e për transport brenda territorit të Republikës së Kosovës ka paguar nga 45 - 100 euro. Me këto veprime, të pandehurit e lartëcekur kanë kryer veprën penale “Kontrabandimi me migrantë” nga neni 164 par. 5 lidhur me nenin 31 dhe 77, sipas KPRK-së.

Ndërsa, të pandehurit A.H., M.H., H.A., O.A., dhe H.M., nga fillimi i muajit mars të vitit 2023, e në vazhdim deri me datë 20.06.2023, merren me kontrabandim me migrantë, në atë mënyrë që i pranojnë migrantët kryesisht arab dhe të shteteve aziatike, nëpërmes rrugëve malore, i kalojnë në territorin e Republikës së Kosovës, ku të njëjtit i grumbullojnë në afërsi të xhamisë së fshatit Vërmicë, ose në afërsi të urës e cila gjendet në autostradë afër fshatit Vërmicë, ku i priste i pandehuri M.H., dhe taksistët të cilët me kombi dhe me vetura udhëtarësh, migrantët e kontrabanduar i transportojnë nga aty, nëpër territor të Republikës së Kosovës.

Pastaj i pandehuri M.H., dhe taksistët të cilët i kishte siguruar ai, i transportojnë më tej deri në afërsi të pikë-kalimit kufitar të Jarinjes, dhe me ndihmën e kontrabandistëve e kalojnë kufirin Kosovë-Serbi, jashtë pikë-kalimit kufitar në mënyrë të paligjshme, kundrejt një përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë financiare.

Me këto veprime, të pandehurit e lartpërmendur kanë kryer veprën “Kontrabandimi me migrantë” nga neni 164 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së.

Gjithashtu, të pandehurit S.G., A.H., H.A., dhe O.A., me datë 19.06.2023, në mesnatë, në Prishtinë, në katin e katërt të objektit banesor që gjendet në rrugën “S.M.”, kanë poseduar armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia e Kosovës në vendin e ngjarjes, të njëjtëve u janë gjetur në posedim tri (3) armë zjarri dhe një numër i konsiderueshëm i fishekëve. Me këto veprime, të njëjtit kanë kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu, i pandehuri O.A., në banesën e lartëcekur në Prishtinë, shkakton rrezik të madh për jetën e personave që kanë qenë brenda banesës, e pikërisht për të pandehurit S.G., A.H., dhe H.A., në atë mënyrë që me pistoletë shtënë disa herë në drejtim të tokës (sheshit) të dhomës së kësaj banese, me ç’rast shkakton rrezik të madh për jetën e tyre. Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1, sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Korrik - Shtator 2024


Prokuroria e Prizrenit Sekuestron dhe Kërkon Shitjen e Dy Kamionëve që Transportonin Zhavorr në Mënyrë të Kundërligjshme

Prizren, 27 Shtator 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, në dy raste të ndara ka sekuestruar dy (2) kamionë, si mjete të kryerjes së veprës penale, të cilët po transportonin zhavorr në mënyrë të kundërligjshme, dhe është iniciuar rast në drejtim të veprës penale “*Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit*” nga neni 338 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokuroria Themelore në Prizren, në koordinim me Policinë e Kosovës, Inspektorët e KPMM-së dhe Inspektorët Komunal, në fshatin Landovicë – Komuna e Prizrenit, në dy raste të ndara ka ndaluar vozitësit e dy kamionëve, të cilët po transportonin zhavorr në mënyrë të kundërligjshme.



Aktivitetet ilegale të nxjerrjes së zhavorrit në këtë fazë hetimore dyshohet se janë zhvilluar përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë.



Brenda afatit ligjor nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, në të dyja rastet e ndara është lëshuar urdhri ndalues i përkohshëm dhe gjithashtu brenda afatit ligjor, për mjetet e kryerjes së veprës penale më datë 27.09.2024 është paraqitur kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar, me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë së specifikuar - shitjen e pasurive të specifikuar/kamionëve për çmim të tregut.

Prokuroria Themelore në Prizren, e njofton opinionin publik se mbetet e përkushtuar maksimalisht në luftimin e dukurive të tilla të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bënë thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e kësaj dukurie degraduese.

